

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve A.Z. dhe D.Z., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit D.Z., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.521/16 datë 21.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.1367/17 datë 17 janar 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.06.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit D.Z., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.521/16 datë 21.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.1367/17 datë 17 janar 2018.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.521/16 datë 21.11.2017, të dënuarin A.Z., e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës

02.03.2016 deri më 01.04.2016, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit në bazë të nenit 47 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) €. Nëse i dënuari nuk mundet apo nuk dëshiron t`a paguaj dënimin me gjobë atëherë gjykata do të revokojë dënimin me gjobë dhe i njëjti do t`i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve. I dënuari është obliguar nga gjykata që të paguaj edhe taksën në shumë prej 30 (tridhjetë) € në emër të kompensimit të viktimave, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nënë kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Të dënuarin D.Z., e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëtdhjetë) ditë, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit në bazë të nenit 47 të KPRK-së i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) €. Nëse i dënuari nuk mundet apo nuk dëshiron t`a paguaj dënimin me gjobë atëherë gjykata do të revokojë dënimin me gjobë dhe i njëjti do t`i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. I dënuari është obliguar nga gjykata që të paguaj edhe taksën në shumë prej 30 (tridhjetë) € në emër të kompensimit të viktimave, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nënë kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PA1.nr.1367/2017 datë 17.01.2018, e ka hedhur si të palejuar ankesën e përbashkët të mbrojtësve të të dënuarve A.Z. av. Y.H. dhe D.Z., Av. S.M., ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Kundër vendimeve të atakuara, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit D.Z., av. Y.H., nga Gjilani për shkak të shkeljes së dispozitave të nenit 46 dhe 47 të KPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t`a miraton kërkesën si të bazuar dhe vendimet e atakuara t`i anulohet ashtu që çështja t`i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.nr.104/2018 datë 25.05.2018, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të mbrojtësit të dënuarit D.Z., pretendohet se edhe pse mbrojtja me prokurorin e shtetit ka lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, konsideron se kjo marrëveshje në raport me dënimin e rekomanduar është lidhur në kundërshtim me nenin me nenin 47 të KPRK-së, ngase në kuptim të kësaj dispozite ligjore, vetëm gjykata është ajo që vendos që dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë, kuptohet me pëlqimin e personit të dënuar, në rastin konkret, ky dënim është zëvendësuar nga prokurori i shtetit dhe si i tillë i është rekomanduar gjykatës me marrëveshjen përkatëse, të cilën edhe gjykata në mënyrë të kundërligjshme e ka aprovuar. Nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë mbrojtësi pretendon se si dënime të rekomanduara dalin dy dënime, njëri me burgim i cili zgjatë 6(gjashtë) muaj i cili do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë dhe tjetri dënim me gjobë në shumë prej 3.000,00 € edhe pse për veprën të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe gjykuar nuk parashihet dënime komulativ.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje shkeljes së dispozitave të nenit 46 dhe 47 të KPRK-së janë të pabazuara. Siç rezulton nga shkresat e çështjes, gjykata e shkallës së parë me datë 15.11.2017, ka mbajtur seancën dëgjimore lidhur me shqyrtimin e pranimin të fajësisë ku në prezencën e prokurorit të çështjes, të dënuarit D.Z. dhe mbrojtësit të tij, pas dëgjimit të tyre dhe konstatimit se i dënuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij e kishte kuptuar drejtë natyrën dhe pasojën e pranimin të fajësisë, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur në këtë çështje penalo juridike. Nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit të dënuarit kur thekson se dënimi me burgim është zëvendësuar me dënim me gjobë nga ana e prokurorit të çështjes dhe si i tillë i është rekomanduar gjykatës e cila e ka aprovuar rekomandimin në mënyrë të kundërligjshme. Nga dispozita e nenit 233 par.13 e KPPK-së del se marrëveshja po ashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohen nga ana e prokurorit të shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon substancialisht ndërsa, nëse gjykata shqipton dënim jashtë

këtyre kufijve në dëm të ndonjëres prej këtyre palëve, ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin. E nga kjo rezulton se i dënuari në rastin konkret pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka bërë marrëveshjen për pranimit e fajësisë dhe ka negociuar përkitazi me vendimin mbi dënim, sipas të cilës marrëveshje të njëjtit i është shqiptuar dënimi në burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit në bazë të nenit 47 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) euro. Rrjedhimisht gjyqtari i çështjes bazuar në diskrecionin e plotë për të vendosur si në rastin konkret, ka shqyrtuar rekomandimin e prokurorit të shtetit, ashtu që të dënuarit me pëlqimin e tij, duke marrë parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese i ka ndryshuar dënimin me burgim duke ia zëvendësuar me dënim me gjobë si të vetmin dënim, në shumë prej 3.000.00 (tremijë) €, duke konstatuar se shqiptimi i këtij lloj dënimi është në harmoni me peshën dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me vendimet e lartëcekura është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nuk qëndrojnë.

Nga arsyet e dhëna më sipër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pml.nr.140/2018, më datë 11.06.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa